



| | |
|-----------------------|------------------|
| HIGJIENA SH.A. | |
| № i punës | 571 |
| Adresa | 05/AJUTINISTRATA |
| № i punës | 03 |
| Data | 28/08/2023 |
| DEÇAN, DEÇAN | |

Ndërmarrja Publike Lokale "Higjiena" Sh.A. Deçan, duke u bazuar në Nenin 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), nenit 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të konkursit në Sektorin Publik, me datë 28.08.2023 shpallë:

KONKURS

Për këto pozita të punës:

- **Kryepunëtor/e;** Një (1)
- **Punëtor/e fizik – mirëmbajtës/e;** Njëmbëdhjetë (11)

I. Titulli i vendit të punës: Kryepunëtor/e;

Numri i pozitave: një (1).

Kohëzgjatja e punës: Në kohë të caktuar/ me mundësi vazhdimi. Puna provuese gjashtë (6) muaj, në pajtim me Ligjin e Punës.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive të punës:

- Cakton ekipet ditore të punës sipas planit operativ;
- Përgatit planet e turneve dhe organizon fushatat e pastrimit;
- Kontrollon kuantitetin dhe kualitetin e punës;
- Mbanë ditarin e punës dhe shënon procesin ditor për mbarëvajtje dhe moskryerje të detyrave të punës;
- Përgjegjës për udhëheqje dhe mbikëqyrje të grupeve punuese;
- Përgjegjës për përdorim të rregullt të pajisjeve dhe të mjeteve të punës;
- Përkujdeset për siguri dhe shëndet të punëtorëve gjatë punës;
- Përgjegjës për disiplinë të punëtorëve gjatë orarit të punës;
- Përgatitë mjete dhe pajisje tjera të nevojshme për punë;
- Organizon, kontrollon dhe përcjellë punën e punëtorëve në zonën në të cilën është i caktuar;
- Mbanë evidencën ditore mbi prezencën e punëtorëve në punë si dhe ditarin e punës mbi ecurinë e procesit të punës;
- Kontrollon kualitetin e kryerjes së shërbimeve, shfrytëzimin e mjeteve në punë, evidenton dhe realizon prioritetet e detyrave të përditshme dhe të rastit;

- Kryen edhe punë tjera sipas urdhëresës së udhëheqësit, nevojës së procesit të punës dhe interesit të kompanisë;

Kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe karakteristikat personale:

- Përgatitja profesionale/ Shkollore: Shkolla e Mesme.
- Përvoja e punës një (1) vit.
- Aftësi të mira komunikimi dhe bashkëpunimi.
- Patentë shofer, kategoria “B”.

II. Titulli i vendit të punës: Punëtor/e fizik – mirëmbajtës/e; dhjetë (10)

Numri i pozitave: njëmbëdhjetë (11).

Kohëzgjatja e punës: Në kohë të caktuar/ me mundësi vazhdimi. Puna provuese gjashtë (6) muaj, në pajtim me Ligjin e Punës.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Bën pastrimin dhe mirëmbajtjen e përgjithshme higjienike brenda objekteve;
- Kujdeset në mënyrë të veçante për pastrimin dhe mirëmbajtjen higjienike të pastërtisë, të mureve, dritareve, dyshemesë dhe inventarit-mobileve në zyrë etj.;
- Bën pastrimin dhe dezinfekton WC-të, largon pluhurin nga inventari, bartë mbeturinat, letrat e përdorura etj.;
- Bën ajrosjen e lokaleve;
- Mirëmban dhe ujitë lulet, pastron oborrin përpara, mbrapa dhe rreth objektit;
- Mirëmban dhe kujdeset për pajisjet të cilat i përdor për pastrimin e objektit;
- Si dhe kryen detyra tjera të cilat (me tutje) mund të jenë të përshkruara në përshkrimin e bashkangjitur ose sipas kërkesës të mbikëqyrësit apo punëdhënësit.

Kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe karakteristikat personale:

- Përgatitja profesionale/ Shkollore: Shkolla e Filllore, e preferuar të ketë shkollën e Mesme;
- Përvoja e punës një (1) vjeçare, që ndërlihet me pozitën apo të ngjashme;
- Aftësi të mira komunikimi dhe bashkëpunimi.

Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

- Aplikacionin e plotësuar;
- Kopjen e dokumentit personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Kopjen e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore;
- Kopjen e dëshmisë së përvojës së punës;

- Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (lëshuar nga Gjykata Themelore, jo më i vjetër se 6 muaj);
- Certifikata e Mjekut, pas përzgjedhjes nga komisioni.

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët që plotësojnë kriteret arsimore dhe profesionale sipas konkursit.
- Pas përfundimit të afatit për aplikim, do të bëhet shqyrtimi dhe vlerësimi i aplikacioneve dhe do të ftohen për intervistë vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet sipas konkursit.
- *Afati për dorëzimin e aplikacionit është nga data: 28.08.2023 deri më 11.09.2023, në Adresën: Objekti i Administratës së NPL "Higjiëna" Sh.A. Rruga "Bjeshket e Deçanit" 51000, Deçan – Kosovë.*

